



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FINIQ
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr. 1541 Prot.

Finiq, më 27.6.2024

NJOFTIM

Mbi dhënien me qira të pyjeve/kullotave dimërore për kullotje e kositje bari

Mbështetur në Ligjin nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr. 02 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, në VKM nr. 632 datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”, në VKM nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, në Vendimin nr. 49 datë 07.12.2023 të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Finiq për vitin 2024” dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë Finiq nr. 02, datë 22.02.2024, “Për miratimin e listës së objekteve kullosore/pyjore të gatshme për kullotje për sezonin veror dhe dimëror 2024 - 2025”, **njoftojmë të gjithë blegtorët e interesuar të paraqesin dokumentacionin si më poshtë vijon:**

Për marrjen me qira të kullotave e livadheve publike për kullotje e kositje që janë shpallur në listë, në çdo rast kërkuesit (personat fizikë apo juridikë) paraqesin kërkesën me shkrim në Drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor:
1) për kullotat dimërore, kërkesa paraqitet brenda datës 10 korrik.

Bashkëngjitur kërkesës janë:

- 1) çertifikata veterinare e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar për gjendjen epizootike të fermës së bagëtive;
- 2) vërtetimi nga njësia Administrative/Bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuesi ka të regjistruar në pronësi;
- 3) lista e objekteve që kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes, si: stane, kasolle për blegtorët, mjedis për përpunimin e bulmetit etj., të tilla sipas rastit;
- 4) kartë Id.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI
Romeo ÇAKULI